
Karta e apostollit Pavël mbë Filimoninë.

Krye 1.

- 1 Pavli, i-lidhurë i Jisu Krishtit, edhe Timotheu, vëllaj, mbë Filimonin' e-dashurë edhe
- 2 bashkëpunëtorinë t'ënë, Edhe mb' Apfin' e-dashurë, edhe mb' Arhippinë bashkëushtëtorinë t'ënë, edhe mbë kishënë ndë shtëpit t'ën-
- 3 de; Hir *qoftë* mbë ju e paqtim prej Perëndisë, Atit t'ënë, edhe prej Zotit Jisu Krisht.
- 4 I falem ndersë Perëndisë t'im, dyke prurë ndër mëntt ty përherë ndë të-falurat të mia,
- 5 Sepse dëgjonj për dashurinë t'ënde edhe për besënë që ke mbë Zotinë Jisu, edhe mbë gjithë
- 6 shënjtorëtë; Që të bënetë shoqëria e besësë s'ate e-pemshime me anë të të-çfaqurit të çdo së-mire që është ndër ju mbë Jisu Kishtinë.
- 7 Sepse kemi shumë gëzim edhe ngushullim për dasurinë t'ënde, sepse zëmërat' e shënjtorëvet janë prëjturë me anë t'ënde, o vëlla.
- 8 Përandaj, ndonëse kam shumë kuxim mbë Jisu Krishtinë të të urdhëronj ty atë që duhetë,
- 9 *Po* për dashurinë më tepërë të lutem, dyke

- qënë i-atillë *që jam*, si plaku Pavel, po nda-
 10 shti edhe i-lidhurë i Jisu krishtit. Të lutem
 për birinë t'im, që më lindi ndër të-lidhurat
 11 të mia, për Onisiminë; I-cili qe njëherë i-
 vëjyerë te ti, po ndashti është i-vëjyerë për
 ty edhe për mua, të-cilinë e dërgova përsëri
 12 Edhe ti prit-e atë, do-me-thënë zëmërenë
 13 t'ime. Unë desha t'a mbanj atë për-anë vetë-
 hesë s'ime që të më shërbenjë ndë vëntt t'ënt,
 14 ndë të-lidhurat të ungjillit; Po pa mëndjenë
 t'ënde nukë desha të bënj asgjë, që të mos
 jet' e-mira jote si prej nevoje, po prej da-
 15 shjeje. Sepse mbase për-andaj unda *prej teje*
 16 për pak kohë, që t'a kesh atë për jetë; Jo
 më si shërbëtuar, po më tepërë se shërbëtuar,
 vëlla të dashurë, veçan tek unë, po sa më tepër-
 17 rë te ti edhe pas mishit edhe mbë Zotinë.
 18 Ndë më ke pra pjesëtar, prit-e atë posi mua.
 19 Edhe ndë qoftë se të ka bërë ndonjë paudhëri,
 19 a të ka detyrë, këtë numëro-m'a mua. Unë
 Pavli shkrova me dorënë t'ime, unë dotë pa-
 guanj; që të mos të them, se edhe vetëhenë
 20 t'ënde m'a ke detyrë. Po, o vëlla, makar të
 marr unë prej teje këtë të-mirë mbë Zotinë;
 21 prëj zëmërenë t'ime mbë Zotinë. Dyke pasurë
 shpresë se dotë *më* dëgjonjë shkrova te ti,
 sepse e di se edhe më tepërë se ç'të them
 dotë bënjë.
 22 Mbë gjithatë kohë bë-më gati edhe vënt
 për të ndënjurë, sepse shprenj se me anë të

- të-faluravet t'uaj dotë dhurëtonem ndër ju.
 23 Të faletë me sëndet Epafraj që është rop
 24 bashkë me mua mbë Jisu Krishtinë, Marku,
 Dhimaj, Llukaj, bashkëpunëtorët' e mi.
 25 Hiri i Zotit t'ënë Jisu Krisht *qoftë* bashkë
 me frymënë t'uaj. Amin.
-